

**STATUT**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“BIG ULLIRI” SH.P.K**

Në Tiranë, më datë 19.092024, Ortakët:

1. Shoqëria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli në Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Valmira Dedgjoni, atësia Lik, e dtl. 05.12.1975, e lindur në Kamëz dhe banuese në Tiranë, me adresë “A.Vokshi”, Nd.104; H.2, Njësia Administrative Nr.9; Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H56205074V lëshuar më datë 23.08.2021;
2. Shoqëria **“B-IDEALGROUP” shpk.**, Person Juridik shqiptar, me Nipt **M31722025S** dhe seli në Tiranë, Rr "Dervish Hima", Nr pasurie 6/369-N5 Zona Kadastrale 8160, përballë, Ambasadës Amerikane, me përfaqësues ligjor **Z. Vladimir Lleshaj**, i biri i Vlashit dhe i Dilës, lindur më 08.04.1978 në Prosek, Mirditë, Shqipëri, dhe me banim në Tiranë, rruga "Hysen Çino", Nd:27, H.1, Njësia Administrative Nr.2;1010, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H80408150T, lëshuar më datë 29.10.2019;
3. **Z. Adriatik Gjoshi**, i biri i Hajdarit, i datëlindjes 15.05.1977, lindur në Hekal, Shqipëri, dhe me banim në Tiranë, në adresën, "Rr. Hajdar Gjoshi, Sanatorium, Sauk", me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë juridike, për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr.personal H70515161W, lëshuar më datë 12.04.2019;

kanë themeluar shoqërinë tregtare “Big Ulliri” sh.p.k, e cila do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqipëtar, Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti, me termat në vijim:

Neni 1

**Emërtimi**

1.1 Shoqëria është emërtuar “Big Ulliri” Sh.p.k.

1.2 Shoqëria është një person juridik Shqipëtar, e cila do të ushtrojë aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë pas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

**Objekti**

2.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë tregëtimi i artikujve të ndryshëm, të të gjitha llojeve, me pakicë si:

- Tregtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë;
- Tregtim artikuj të ndryshëm bujqësorë e blegtoralë;

- Tregtim fruta – perime;
- Tregtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë;
- Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Tregtim mallrash të tëgjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Tregtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, pajisje zyrash etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojëra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
- Tregtimin e karburantëve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikantë, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregtimin e tyre me pakicë.
- Tregtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista etj

2.2 Shoqëria mund ta zgjerojë objektin e veprimtarisë të saj, duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe duke pasqyruar ndryshimet në këtë Statut.

**2.3 Shoqëria nuk do të kryejë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushteti vendor dhe as të fitojë pasuri të këtyre me qëllim zbatimin me korrektësi të pikës 3 të nenit 70, të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë.**

Neni 3

#### **Selia**

3.1 Shoqëria “Big Ulliri” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: " Rr. *Hiqmet Buzi, Zona Kadastrale 8280, Nr. Pasurie 1/90, Tiranë* ".

3.2 Shoqëriaka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, degë, filiale, agjensi, si dhe ti suprimojë ato.

Neni 4

#### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

4.1 Shoqëria “Big Ulliri” Sh.p.k do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

Neni 5

#### **Kapitali i Shoqërisë**

5.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është **15.000.000 (pesëmbëdhjetë milionë)** lekë, i përbërë nga kontributet e ortakëve si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
<b>BIGALB GROUP</b>	<b>1</b>	<b>40%</b>	<b>6.000.000</b>
<b>B-IDEALGROUP</b>	<b>1</b>	<b>40%</b>	<b>6.000.000</b>
<b>ADRIATIK GJOSHI</b>	<b>1</b>	<b>20%</b>	<b>3.000.000</b>



5.2 Kuotat e kapitalit janë shlyer tërësisht në të holla nga ortakët themelues.

5.3 Në librat e shoqërisë do të shënohet kapitali i derdhur dhe kuotat e pjesëmarrjes për secilin ortak.

5.4 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor, dhe të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

5.5 Ortakët, në këtë sipërmarrje, kanë derdhur kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhura, që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private, si dhe të përballojnë humbjet në kuotën e pjesëmarrjes së secilit ortak.

5.6 Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve.

5.7 Trashëgimtari hyn në Shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut dhe me të gjitha efektet.

5.8 Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund t'u kalojnë, t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim asambleje të ortakëve të shoqërisëdhe me akt noterial.

Neni 6

### **Fitimi**

6.1 Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë do të administrohet nga ortakët.

6.2 Një pjesë e fitimit mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar.

6.3 Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve si dhe të sigurojë rezervën ligjore

Neni 7

### **Asambleja e Përgjithëshme**

7.1 Organi drejtues i shoqërisë është: **Asambleja e Përgjithëshme**

7.2 Asambleja e Përgjithëshme thirret për të vendosur, me kërkesën e administratorit ose të çdo ortaku që përfaqëson jo më pak se 10% të kapitalit.

7.3 Në çdo rast është në juridiksionin e Asamblesë së Përgjithëshme:

- Emërimi dhe shkarkimi i administratorit
- Miratimi i llogarive dhe shpërndarja e fitimit
- Emërimi në rastet e parashikuara nga ligji të ekspertëve
- Modifikimi i statusit
- Vendimet lidhur me operacionet që përbëjnë një modifikim thelbësor të objektit të aktivitetit
- Vendimet relative:

- Për realizimin e operacioneve që impenojnë shoqërinë për një vlerë rast pas rasti më të madhe se 20.000 (njëzetë mijë) Euro
- Rritje ose zvogëlim të kapitalit
- Marrjen e kredive
- Prishjen e shoqërisë

7.4 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e ortakëve dhe vota e tij ka vlerë në proporcion me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e shoqërisë.

7.5 Asambleja e Përgjithëshme mbledhet çdo vit, brenda katër muajve, nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë.

Neni 8

#### **Administratori**

8.1 Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Mario Lazri**

8.2 Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.3 Mandati i Administratorit mund të jetë i rinovueshëm.

8.4 Asambleja e Përgjithëshme gëzon të drejtën në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.

8.5 Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave të atribuara vendimarrjes së Asamblesë së Përgjithëshme, në kuptim të ligjit dhe të këtij statuti dhe kufizimeve të vendosura në aktin e emërimit të tij.

**8.6 Administratori i Shoqërisë nuk ka të drejtë dhe kompetencë për të nënshkruar kontrata apo çdo lloj marrëveshje, që në një menyre apo tjetër, ka lidhje me veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre, me qëllim zbatimin me korrektësi të pikës 3 të nenit 70, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.**

Neni 9

#### **Viti financiar. Llogaritë vjetore. Detyrime të tjera.**

9.1 Viti financiar fillon më 1 Janar të çdo viti dhe përfundon më 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.

9.2 Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabël miratohen nga Asambleja e Përgjithëshme.

9.3 Miratimi i dokumentave financiarë vjetorë bëhet brenda një afati 3-mujor, të mbylljes së vitit financiar.

9.4 Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, shoqëria mund të krijojë dhe fonde të tjera.

9.5 Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore etj.

9.6 Shoqëria ka të drejtë të çeli llogari likujduese pranë bankave të vendit dhe të kryejë veprime likuidimi me to.



Neni 10

**Likujdimi i shoqërisë**

10.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, emërohet një nga disa likujdatorë të cilët ndjekin operacionet e likujdimit deri në fund dhe i paraqesin Asamblesë së Përgjithëshme dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likujdimit. Në përfundim Asambleja e Përgjithëshme vendos për heqjen e mandatit të tyre.

10.2 Asambleja e Përgjithëshme do të vendosë për mënyrën dhe modalitetet e shlyerjes së detyrimeve që dalin nga procesi i likujdimit.

Neni 11

**Ndryshimet në statut**

11.1 Ortakët e Shoqërisë mund të bëjnë, në çdo kohë, ndryshime e plotësime në Statut dhe në aktin e themelimit, pa rënë ndesh, në mënyrë thelbësore, me nenet e përshkuara në këtë Statut.

11.2 Ndryshimet e plotësimet, në këtë statut, bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë të cilën nxirret vetë statuti.

Neni 12

**Ligji i zbatueshëm**

12.1 Për çështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë statut, gjithçka i referohet ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, legjislacionit shqipëtar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në tre kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Datë 19/09/2024

**ORTAKËT THEMELUES**

Shoq. "Bigalb Group" sh.p.k.

Z. Vullnet Sinaj

Personi besuar

Znj. Valmira Dedgjoni

  


Shoqëria "B-IDEALGROUP" Sh.p.k

Z. Vladimir Lleshaj

  


Z. Adriatik Gjoshi

  
